

VENDIM Nr. 3, datë 27.3.2020

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT NË SUBJEKTET E BIZNESIT ME TË ARDHURA VJETORE DERI 14 MILIONË LEKË, NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË PAGESËS TË SË ARDHURËS NGA PAPANËSIA GJATË PERIUdhËS SË FATKEQËSISË NATYRORE, TË SHPALLUR SI PASOJË E COVID-19

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të pikës 16, të nenit 3, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohës së kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID19”, të ndryshuar, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përbalimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19”, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 25.3.2020,

VENDOSI:

1. Dhënie ndihme financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14,000,000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik/marrëdhënies të punës, për shkak të gjendjes së epidemisë nga COVID-19, sipas urdhrave përkatës të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Dhënien e një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike.

3. Dhënien e një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesën e të ardhurës nga papunësia.

4. Miratimin, në parim, të projektvendimit të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike dhe të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e covid19”, të propozuar nga ministri i Shtetit për Rindërtimin, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOR TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINTËR
Edi Rama

Botuar ne F.Zyrtare 53/2020

Dale nga shtypi date 28.03.2020